



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.101

2005

9 janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4733 datë 20.12.2005	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3199
Dekret nr.4735 datë 21.12.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	3199
Dekret nr.4738 datë 28.12.2005	Për lirim ambasadori.....	3200
Dekret nr.4739 datë 28.12.2005	Për emërim ambasadori.....	3200
Vendim i GJK nr.34, datë 20.12.2005	Me objekt shfuqizimin e nenit 1 të ligjit nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën	3201
Vendim i GJK nr.35, datë 20.12.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.368, datë 14.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.493, datë 30.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.42, datë 21.01.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	3207
Vendim i GJK nr.36, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1567, datë 27.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.241, datë 29.04.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.313, datë 5.02.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), si të papajtueshme me Kushtetutën.....	3210
Vendim i GJK nr.37, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimi i vendimit nr.534, datë 13.07.2005 i Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të	

	Bashkisë Kamëz, qarku Tiranë”	3213
Vendim i GJK nr.38, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimi i vendimit nr.527, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Slllovë, qarku Dibër”	3215
Vendim i GJK nr.39, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimi i vendimit nr.529, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Fushë-Çidhën, qarku Dibër”, si antikushtetues.....	3217
Vendim i GJK nr.40, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimi i vendimit nr.528, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Luzni, qarku Dibër”, si antikushtetues.....	3219
Vendim i GJK nr.41, datë 29.12.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.356, datë 14.04.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.327, datë 28.05.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	3221

DEKRET
Nr.4733, datë 20.12.2005

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:

Zana Naim Krasniqit

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4735, datë 21.12.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|--|
| 1. Fatbardha Mustafa Shehu (Kurushi) | 21. Alma Arqile Kita |
| 2. Loreta Ilir Shehu | 22. Amarilda Enver Goseni |
| 3. Ilban Ilir Shehu | 23. Enkeleida Vasil Stauter (Preka) |
| 4. Hamide Avdulla Helms (Xhepa) | 24. Spartak Qemal Baqoshi |
| 5. Vera Hysen Elshani (Kica) | 25. Deniz Alban Spartak Baqoshi |
| 6. Elona Afrim Elshani | 26. Sara Spartak Baqoshi |
| 7. Ramadan Faredin Kumani | 27. Diamanta Muharrem Cekani (Hoxha) |
| 8. Dea Agim Otto (Isaku) | 28. Meggi Saimir Cekani |
| 9. Daores Avni Mataj | 29. Dallandyshe Alit Jaupi (Shatrolli) |
| 10. Klaudia Rodolf (Rudolf) Adhami | 30. Janin Agim Jaupi |
| 11. Edmond Idriz Bardhi | 31. Julia Agim Jaupi |
| 12. Nikoll Gjok Gjoka | 32. Sara Agim Jaupi |
| 13. Margarita Sherbet Kokoshi (Karuli) | 33. Anila Musli Arnold (Berisha) |
| 14. Ilirjan Qemal Konçi | 34. Anila Dhimitër Peri |
| 15. Engjellushe Isuf Konçi (Fagu) | 35. Andrea Dhimitri Curra |
| 16. Enli Ilirjan Konçi | 36. Orhan Bajram Zenelaj |
| 17. Marvi Ilirjan Konçi | 37. Isabella Michelle Orhan Zenelaj |
| 18. Aleme Zyrdi Çako (Mersinaj) | 38. Luljeta Hariz Zenelaj (Shima) |

19. Skënder Islam Wanders (Sulku)
20. Arbjola Arben Ohri

39. Orjeta Orhan Zenelaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4738, datë 28.12.2005

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika dh dhe nenit 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kujtim Xhani lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 4739, datë 28.12.2005

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika dh dhe nenit 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Maxhun Peka, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 34, datë 20.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 7.6.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.27 Akti, që i përket:

KËRKUES: 1.SHOQATA KOMBËTARE ANTIKOMUNISTE E ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

2.SHOQATA MBARËKOMBËTARE PËR INTEGRIMIN E TË BURGOSURVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË TË SHQIPËRISË

3.SHOQATA KOMBËTARE E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË, të gjitha të përfaqësuara nga avokatët Rustem Gjata e Rushit Demo, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Viktor Gumi, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Sokol Shazi dhe Monika Zeqo, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 1 të ligjit nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 shkronja “a” dhe 134 shkronja “f”, në lidhje me nenet 4/1; 18 dhe 44 të Kushtetutës; nenet 49 paragrafi 2 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, etj.

Shkaqet e paraqitura nga kërkuesit janë:

- Neni 1 i ligjit që kontestohet, ka një sërë kundërthëniesh e pasaktësish. Kështu, në pjesën e parë të tij flitet për “Kompensim financiar të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë ...”, ndërsa më pas, po në këtë nen, konkretizohet se këtë të drejtë e përfitojnë vetëm të dënuarit politikë. Nga ana tjetër ky nen bie në kundërshtim të hapur me nenet 7 dhe 8 të këtij ligji, të cilat përcaktojnë kuptimin dhe përmbajtjen e kompensimit pasuror, si dhe kategoritë e personave që përfitojnë nga ky kompensim.

- Nuk është e qartë se mbi çfarë kriteresh është mbështetur Qeveria dhe Kuvendi kur kanë caktuar përfitimin e së drejtës së “kompensimit financiar në mënyrë të përshkallëzuar mbi bazën e vuajtjes së dënimit”.

- Neni 1 përbën një zbrapsje të madhe lidhur me të drejtat e njohura me ligjet e mëparshme. Ai përbën shkelje të të drejtave të njohura me Kushtetutë dhe me ligj.

- Me shumat e caktuara në nenin 1 të ligjit objekt kërkese, nuk mund të bëhet fjalë për respektimin e së drejtës së rehabilitimit e zhdëmtimit, të garantuar në nenin 44 të Kushtetutës dhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Është cenuar parimi i barazisë para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit, të garantuara nga neni 18 i Kushtetutës. Me analogji, kompensimi apo shpërblimi i dëmit për dënimin e vuajtur pa të drejtë nga të burgosurit e të përndjekurit politikë, duhet të llogaritet në mënyrën dhe masën e parashikuar në nenin 57 të Kodit Penal;

- Ish-të dënuarit dhe të përndjekurit e tjerë nuk kanë përfituar kompensimin pasuror as përafërsisht për dënimin e vuajtur, pa folur pastaj për punën e papaguar, e cila nuk është paguar fare.

- Në raportin qeveritar që ka shoqëruar në Kuvend ligjin që kontestohet, vihet theksi në pamundësinë e përballimit të faturës financiare, duke injoruar të drejtën e të burgosurve dhe të përndjekurve politikë për kompensimin dhe shpërblimin për dënimin e vuajtur dhe për punën e papaguar. Përballimi ose jo i faturës financiare ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe jo me vetë të drejtën e kompensimit e shpërblimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e kërkuësve, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka aprovuar ligjin nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, neni 1 i të cilit ka ndryshuar nenin 9 të po këtij ligji, si më poshtë: “Kompensimi financiar i ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që kanë marrë pafajësinë sipas ligjit nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë ...”, ... dhe që gëzojnë statusin sipas ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin ...”, ish-të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë “A”, të cilët kanë humbur jetën apo janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes ose trashëgimtarit të radhës së parë sipas Kodit Civil, si dhe ish-të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë “B” të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Për Statusin ...”, ... përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar në mënyrë të përshkallëzuar mbi bazën e vuajtjes së dënimit si më poshtë:

Periodha e vuajtjes së dënimit	Pagesa mujore në lekë
1 deri në 5 vjet	1500
5 deri në 10 vjet	2000
10 deri në 15 vjet	2500
15 deri në 20 vjet	3000
20 deri në 30 vjet	3500
Të pushkatuar	5000”.

Kërkuësit, shoqata që kanë si anëtarë ish-të burgosur dhe të përndjekur politikë dhe si synim kryesor mbrojtjen e interesave të tyre, legjitimohen në paraqitjen e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dispozitës së mësipërme të ligjit nr.9260, datë 15.07.2004. Ato kanë interes të drejtpërdrejtë në rregullimin ligjor të problemeve që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin, kompensimin dhe riintegrimin e kësaj kategorie personash në shoqërinë shqiptare. Ky fakt pasqyrohet edhe në statutin e të tre organizatave kërkuëse.

Meqenëse çështja është mjaft komplekse, Gjykata Kushtetuese vlerëson të nevojshme të bëjë një paraqitje të përgjithshme të problemit, si dhe të kuadrit ligjor ekzistues që rregullon çështjen e dëmshpërblimit dhe të kompensimit të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

Gjatë regjimit komunist në Shqipëri, me mijëra njerëz janë pushkatuar, burgosur dhe përndjekur për arsye politike. Të burgosurit dhe të përndjekurit politikë kanë qenë të detyruar të jetojnë në kushte tepër të vështira. Trajtimi i tyre në atë kohë konsiderohet sot si diskriminues dhe antinjerëzor. Për shkak të këtyre kushteve, shumë prej tyre edhe kanë vdekur, janë gjymtuar ose kanë marrë sëmundje të ndryshme shpeshherë të rënda dhe të pashërueshme. Një jetë me mjaft probleme e vështirësi shoqëronte pothuajse gjithnjë edhe familjarët dhe të afërmit e tjerë të të pushkatuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politikë. Shpesh, ata internoheshin dhe detyroheshin të punonin në punë të rënda dhe të dorës së dytë, i sekuestrohej një pjesë e mirë e pasurisë, përjashtoheshin nga pjesëmarrja apo veprimtari të rëndësishme shtetërore e shoqërore, u mohojë shkollimi i lartë, privoheshin edhe nga shumica e atyre pak lirive dhe të drejtave që deklaronte legjislacioni i asaj periudhe, etj.

Marrë në tërësi, burgosjet, ekzekutimet pa gjyq, torturat, trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor ose degradues, deportimet dhe diskriminimi sistematik ndaj kësaj kategorie njerëzish, konsiderohen si shkelje të rënda të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Sipas së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore, shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut ngrenë patjetër edhe çështjen e dëmshpërblimit të viktimave të këtyre shkeljeve.¹ Në Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe Abuzimit me Pushtetin, aprovuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB nr.40/34, datë 29 nëntor 1985, theksohet ndër të tjera se “viktimat kanë të drejtën për dëmshpërblim të menjëhershëm për dëmin e pësuar, dhe se shtetet duhet të

1. Shih Raportin e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare në A/CN 4/90, 1997

përpiqen të parashikojnë kompensim financiar”¹. Nga ana tjetër, Komisioni i të Drejtave të Njeriut pranë Këshillit Ekonomiko-Shoqëror të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ka theksuar disa herë se pavarësisht nga: “eksperienca pozitive e vendeve që kanë zbatuar politika dhe aprovuar legjislacion mbi dëmshpërblimin, kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, i bëhet edhe një herë thirrje bashkësisë ndërkombëtare për t’i kushtuar vëmendjen e duhur së drejtës së dëmshpërblimit, kompensimit dhe rehabilitimit të viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut”.² Ashtu si në shumicën e vendeve të tjera të Europës Qendrore e Lindore, që për gati gjysmë shekulli vuajtën nën regjimin totalitar komunist, edhe në Shqipëri, pas ndryshimeve demokratike, lindi natyrshëm nevoja e ndërmarrjes së nismave konkrete praktike e ligjore për dëmshpërblimin, kompensimin dhe rehabilitimin e ish-të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist. Pavarësisht nga problemet e shumta të trashëguara nga e kaluara komuniste, pavarësisht nga vështirësitë me të cilat ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare, shteti demokratik ka detyrën dhe përgjegjësinë morale e historike që brenda mundësive që diktohen nga kushtet ekonomike e shoqërore, ta respektojë këtë të drejtë, duke marrë masa konkrete për të gjetur një zgjidhje të shpejtë, të përshtatshme e të qëndrueshme në këtë drejtim.

Gjykata Kushtetuese e konsideron me rëndësi të theksohet se dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë për dëmin personal, për vuajtjet apo punën e papaguar të tyre gjatë regjimit të kaluar, nuk mund të bazohen në kuadrin ligjor të periudhës para tranzicionit. Shkelja brutale e lirive dhe e të drejtave themelore, padrejtësitë e theksuara të atij regjimi ndaj kësaj kategorie të personave, bëhej për motive politike e ideologjike dhe justifikohesh me praktikën dhe legjislacionin antidemokratik dhe antinjerëzor të asaj periudhe. Prandaj e drejta e dëmshpërblimit dhe e kompensimit të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, pas përmbysjeve të rëndësishme politike e shoqërore që ndodhën edhe në vendin tonë, nuk mund të trajtohet si një e drejtë subjektive. Shteti demokratik i dëmshpërblen e kompenson këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë.³

Parimi i drejtësisë, në thelb, kërkon të merren në konsideratë edhe interesat e anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si dhe interesi publik në tërësi. Është e pamundur të eliminohen të gjitha padrejtësitë e shumta e të thella të bëra në vite ndaj këtyre personave nga regjimi komunist. Synim kryesor duhet të jetë zvogëlimi sa më shumë i pasojave të këtyre padrejtësive.⁴ Për këtë qëllim nevojitet edhe një bashkëpunim konstruktiv i organeve respektive shtetërore me përfaqësues të shoqatave të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, në mënyrë që zgjidhjet të jenë sa më të shpejta, sa më efektive dhe sa më të qëndrueshme.

Nga ana tjetër, parimi i barazisë kërkon ndalimin e diskriminimit dhe trajtim të barabartë në të drejta të të gjithë viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjej trajtimi ndryshe i kategorive të caktuara të personave që përfitojnë nga kjo e drejtë. I tillë mund të ishte rasti i diferencimit në trajtim i personave që kanë vuajtur më gjatë dhe më shumë në burgjet e regjimit komunist, diferencimi për shkak të moshës, diferencimi i të afërmeve të personave të vdekur ose të pushkatuar për arsye politike, etj. Megjithatë, ajo që ka rëndësi të theksohet është se në këtë rast, parimi i barazisë “... nuk do të thotë që të gjithë ata duhet të marrin të njëjtën shumë në para, por që të gjithë duhet të përfitojnë njëloj të njëjtat të drejta, brenda hapësirës që përcakton ligji”.⁵ Ide qendrore duhet të jetë respektimi i dinjitetit të barabartë të çdo personi që për shkak të burgosjes apo përndjekjes për arsye politike gjatë regjimit komunist, përfiton nga Kushtetuta apo ligji të drejtën për dëmshpërblim dhe kompensim.⁶

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese thekson se dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist duhet të kenë njëkohësisht vlerësim simbolik dhe

1. UN/GA Resolution, 29 November 1985

2. Shih “Commission of Human Rights, Sesion 55/99, fq.2

3. Në të njëjtin përfundim ka arritur në një çështje të kësaj natyre edhe Gjykata Kushtetuese e Hungarisë. Shih vendimin e saj nr.1, viti 1995, Hun –1995 - 1 - 001

4. Shih edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 01.12.2005

5. Shih Neil KRITZ “Transitional Justice”, në United States Institute of Peace, Washington DC, Vol.1, cituar nga Paczolay..5/5

4. Shih edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese Hungareze 1-001-1995

5. Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Gjermane në BvR 1804/03, datë 07.12.2004

financiar.¹ Kjo do të thotë se këta persona që vuajtën kaq shumë gjatë regjimit komunist, jo vetëm duhet të përfitojnë konkretisht diçka si shenjë e detyrimit, vëmendjes dhe angazhimit të shtetit dhe shoqërisë ndaj tyre. Dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë duhet të jenë më shumë se kaq. Ai duhet të jetë i tillë që të marrë parasysh edhe vuajtjet e shumta, dinjitetin e tyre, hallet dhe problemet me të cilat ballafaqohen ata në jetën e përditshme. Dëmshpërblimi dhe kompensimi në tërësi duhen kuptuar si detyrime pozitive të shtetit për të marrë masat e duhura që lehtësojnë sa më shumë rehabilitimin dhe riintegrimin e kësaj kategorie njerëzish në shoqërinë shqiptare.

Gjykata Kushtetuese konstaton se çështja e dëmshpërblimit dhe e kompensimit të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë ka filluar të trajtohet ligjërisht që në vitin 1991. Në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, në pjesën hyrëse të tij, theksohet detyrimi i Qeverisë për “... të marrë të gjitha masat që të kompensojë dhe rehabilitojë të gjithë personat që janë akuzuar padrejtësisht për shkelje për të cilat bën fjalë ky ligj dhe të sigurojë për ta, me përparësi, ndihmën materiale dhe morale për t’u riintegruar plotësisht në shoqëri”. Në pikën “dh” të nenit 5 të këtij ligji saktësohet më tej se “Kompensimi për dëmet e shkaktuara u jepet edhe familjeve ose trashëgimtarëve të ligjshëm të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më, si dhe të atyre që janë pushkatuar pa gjyq ose që kanë vdekur pa u dënuar nga gjykata”, etj. Me ligjet nr.7660, datë 14.1.1993; nr.7719, datë 8.6.1993; nr.7772, datë 7.12.1993 dhe nr.8997, datë 30.1.2003 i janë bërë disa shtesa e ndryshime ligjit të mësipërm. Ndër to, vlen të përmendet edhe përfshirja e të internuarve për motive politike në kampe të caktuara internimi, respektivisht deri në fund të viteve 1954, 1958, 1961 dhe 1966, si subjekte që përfitojnë disa nga të drejtat që njeh ligji, përfshirë këtu edhe të drejtën për kompensim.

Megjithatë, çështja e dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, pavarësisht se buron nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë ...”, saktësohet dhe rregullohet në mënyrë më të plotë në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”. Ndër të tjera, neni 7 i këtij ligji përcakton nocionin e kompensimit pasuror të këtyre personave si një “shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim në rrogë, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t’i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij, ..., në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve ...”. Në nenin 8 sqarohet më tej se këtë kompensim pasuror e përfitojnë kategoritë e përmendura në nenin 3 shkronjat “a, b, c”, dhe se nga kjo e drejtë nuk përfitojnë të përndjekurit e shkronjës “c” (të internuarit dhe të dëbuarit), të cilët gjatë kohës që kanë gëzuar liri të kufizuar janë paguar për punën e kryer.

Për çështjen në gjykim ka rëndësi të përmendet veçanërisht neni 9 i këtij ligji, i cili përcakton kohën për të cilën do të llogaritet kompensimi (paragrafi i parë), si dhe kriteret mbi bazën e të cilave do të llogaritet ky kompensim (paragrafi i dytë). Aty theksohet shprehimisht se si kohë: “... do të jetë kohëzgjatja e plotë në ditë e dënimit sipas shkronjave “b dhe c” të nenit 3” të po këtij ligji, ndërsa llogaritja në vlerë e kompensimit pasuror urdhërohet të bëhet: “duke u bazuar mbi pagën bazë më të lartë të sistemit të minierave që rezulton nga viti 1945 deri në 31.12.1990, korrigjuar me indeksin mesatar të rritjes së çmimeve në momentin e llogaritjes së kompensimit”.

Në zbatim të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin ...”, dhe konkretisht të neneve 7, 8, 9, 11 dhe 13 të këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxori vendimin nr.184, datë 4.5.1994 “Për dhënien e kompensimit pasuror ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”. Ndër të tjera, në këtë vendim saktësohet se “Kompensimi pasuror ... do të bëhet kryesisht me letra me vlerë...”(pika 1); se “ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë që kanë përfituar të drejtën e kompensimit pasuror sipas ligjit “Për statusin ...”, në zbatim të neneve 7 dhe 9, përfitojnë në formën e letrave me vlerë një kompensim vjetor prej 120.000 lekë (pika 2); se ata kanë të drejtë të marrin pjesë pa ankand në procesin e privatizimit të pronës shtetërore; kanë të drejtë t’i shesin, disponojnë ose këmbejnë në të gjitha format që përcakton ligji letrat me vlerë, etj. Në vendim, përcaktohen gjithashtu kategori të ndryshme të të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që mbi bazën e disa kriterëve objektive (mosha, masa e dënimit, gjinia), do të përfitonin të drejtën të merrnin në të holla një pjesë të kompensimit. Kjo shumë, sipas rasteve të caktuara, varion nga 100000 deri në 300000 lekë.

Ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin ...” i janë bërë më pas disa shtesa e ndryshime të

pjesëshme. Megjithatë, shtesat dhe ndryshimet më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti me çështjen e dëmshpërblimit dhe kompensimit të të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, janë bërë në ligjin që është edhe objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

Vlen të theksohet gjithashtu se, ndërkaq, e drejta e rehabilitimit dhe e zhdëmtimit në tërësi garantohet shprehimisht edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998. Në nenin 44 theksohet se: “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Iniciativën për hartimin dhe aprovimin e ligjit objekt shqyrtimi e ka ndërmarrë një grup prej 53 deputetësh të Kuvendit, mbështetur nga disa shoqata të të burgosurve dhe të përndjekurve politikë. Ide qendrore për ndërmarrjen e kësaj nisme ka qenë nevoja për të korrigjuar disa nga të metat apo gabimet e bëra në trajtimin e ish-të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, duke pasur parasysh kryesisht çështjen e dëmshpërblimit dhe kompensimit të tyre. Për këtë qëllim, ndër të tjera kërkohej zbatimi i kriterëve të reja për kompensimin pasuror (duke pasur parasysh në radhë të parë masën që përcakton neni 57 i Kodit Penal në fuqi), dëmshpërblimin për punën e papaguar, si dhe gjetjen e mundësive për t’i bërë efikase letrat me vlerë të marra nga ish-të burgosurit dhe të përndjekurit politikë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.184, datë 04.05.1994, por që shumica e tyre (rreth 60%) praktikisht ende kanë mbetur pa u shfrytëzuar. Po sipas iniciatorëve, dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve dhe të përndjekurve politikë, garantuar tashmë edhe në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ka qenë më shumë fiktiv se sa real. Ai nuk ka ndihmuar apo lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

Mbi bazën e kësaj iniciative, por në ndryshim nga projektligji i paraqitur nga 53 deputetët, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9260, datë 15.7.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, neni 1 i të cilit kërkohej të shfuqizohej si antikushtetues nga kërkuuesit.

Kërkuuesit kanë paraqitur disa pretendime që sipas tyre e bëjnë antikushtetues nenin 1 të ligjit nr.9260, datë 15.7.2004. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese konstaton se si shkak për deklarimin antikushtetues të kësaj dispozite është pretendimi i parë i tyre, fakti se ajo ka një sërë kundërthëniesh e pasaktësish, të cilat e bëjnë të pakuptueshme dhe të pazbatueshme në praktikë. Shkaqet e tjera të ngritura nga kërkuuesit jo vetëm që thithen nga pranimi i këtij pretendimi, por ato në tërësi marrin përgjigje nga shtjellimi që u është bërë më sipër parimeve të përgjithshme mbi bazën e të cilave bëhet dëmshpërblimi dhe kompensimi i të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese e konsideron të rëndësishme të theksohet se shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës sonë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkëlja e tij përbën në vetvete bazë (të mjaftueshme) për deklarimin e një ligji si antikushtetues.

Një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, i cili, ndër të tjera, ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme.¹ Sigurisht që ato nuk mund të parashikojnë çdo rast që mund dhe duhet të lindë nga njohja dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj, në radhë të parë është detyrë e gjykatave apo e organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për

1 Shih Peter BADURA “Staatsrecht”, Munchen 1996, fq.51D. Për lidhjen e parimit të shtetit të së drejtës me atë të sigurisë juridike, shih edhe Juha RAITO “Legal Certainty”-IVR Encyclopaedia of Jurisprudence, Legal Theory and Philosophy of Law”, 5/2005

subjektet të cilëve u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij.¹

Bazuar në këto standarde, Gjykata Kushtetuese çmon se në nenin 1 të ligjit nr.9260, datë 15.7.2004 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin ..., i ndryshuar”, konstatohen këto probleme kryesore:

1. Nuk del qartë *ratio legis*, pra qëllimi i hartimit të këtij neni dhe raporti i tij me nenin 9 të mëparshëm të po këtij ligji, të cilin ai ndryshon. Nuk sqarohet nëse neni 9 i mëparshëm është konsideruar si i pamjaftueshëm, i pazbatuar, i zbatuar tërësisht apo pjesërisht.

2. Në nenin 1 flitet për kompensim financiar, ndërsa në nenet 7 e 8 të ligjit flitet për kompensim pasuror. Për kompensim pasuror bënte fjalë edhe neni 9 i mëparshëm, i cili ndryshohet nga neni 1 i ligjit të ri. Në këtë kuptim, nuk sqarohet nëse neni 1 i ligjit të ri garanton një lloj të ri kompensimi, është pjesë apo plotësim i kompensimit të mëparshëm, apo nëse në thelb bëhet fjalë për një lloj asistence suplementare mbi të ardhurat e realizuara nga të burgosurit dhe të përndjekurit politikë, ashtu siç është deklaruar në emër të Këshillit të Ministrave në seancën e miratimit të këtij ligji.

3. Neni 1 i ligjit nr.9260, datë 15.7.2004, që ndryshon nenin 9 të mëparshëm, jep një formulim të ri kompensimi dhe përcakton kategoritë e personave që përfitojnë nga ky kompensim, të cilët ndryshojnë dukshëm nga ato që parashikojnë nenet 7 e 8 të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin...”. Këto nene, ende konsiderohen si në fuqi përderisa në ligjin e ri nuk kërkohet shprehimisht shfuqizimi i tyre, ashtu siç veprohet për nenin 9 të ligjit.

4. Sipas nenit 1, në emër të të pushkatuarve që ligjërisht kanë statusin e kategorisë “A”, përfitojnë të drejtën për kompensim financiar vetëm trashëgimtarët e radhës së parë sipas Kodit Civil, pra vetëm fëmijët dhe bashkëshorti tjetër apo të paslindurit e fëmijëve që mund të kenë vdekur në vijë të drejtë pa kufizim (neni 361 i Kodit Civil). Ky deklaram bie ndesh me nenin 5, shkronja “dh” të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë ...”, si dhe nenin 14 të vetë ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin...”, në të cilët përcaktohet se e drejta e kompensimit pasuror mund t’u transmetohet trashëgimtarëve të ligjshëm të përcaktuar sipas dispozitave të Kodit Civil mbi trashëgiminë. Për më tepër, neni 1 nuk përcakton se përsa kohë do ta përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar trashëgimtarët e radhës së parë të ish-të dënuarve politikë që përfshihen në kategorinë “A”.

5. Nuk përcaktohet se përsa kohë do ta përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar ish-të burgosurit politikë. Po kështu, për të dënuarit politikë që kanë vdekur në burgje, nuk saktësohet nëse ata do të kompensohen për të gjithë kohën e dënimit apo vetëm për kohën faktike të vuajtjes së dënimit deri në momentin e vdekjes.

6. Neni 1 përjashton nga e drejta e kompensimit financiar të internuarit politikë që kanë fituar statusin e grupit “C”, dhe që në bazë të nenit 6 të ligjit nr...7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë...”, nenit 1 të ligjit nr.7772, datë 7.12.1993 për disa ndryshime në ligjin “Për pafajësinë...”, dhe neneve 8 e 14 të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin...”, përfitojnë të drejtën e kompensimit pasuror.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se neni 1 i ligjit nr.9260, datë 15.07.2004 duhet të shfuqizohet si antikushtetues, pasi në përmbajtjen e tij ka një sërë pasaktësisht e paqartësish, sqarimi i të cilave është mëse i domosdoshëm për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të tij në praktikë.

Me shfuqizimin e kësaj dispozite krijohet boshllëk ligjor, prandaj i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që në bazë edhe të këtij vendimi, të ndërmarrrë hapat e nevojshëm në këtë drejtim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131 shkronja “a”, 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Gjermane 2BvR 2374/99, datë 18.05.2004 dhe BvR 581/01, datë 12.4.2005, etj.

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 1 të ligjit nr.9260, datë 15.7.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 35, datë 20.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 28.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.44 Akti, që i përket:

KËRKUESI: FERIT SALIA, përfaqësuar nga avokate Enise Kurteshi, me prokurë.

SUBJEKT I I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues, i vendimeve nr.368, datë 14.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.493, datë 30.06.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.42, datë 21.01.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 29/3, 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Shkaqet e paraqitura nga kërkuesi për deklarimin antikushtetuese të vendimeve të mësipërme janë:

- Kur çështja është gjykuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, kishte ndryshuar neni 134 i Kodit Penal. Masa e re e dënimit që parashikohet në të dy paragrafët e këtij neni është dukshëm më e lehtë nga ajo që parashikohej më parë. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar kërkesën kushtetuese për t'i dhënë fuqi prapavepruese ligjit penal favorizues;

- Në gjykimin e shkallës së parë, avokati ka kërkuar gjykim të shkurtuar, duke tejkaluar në këtë mënyrë tagrat e përfaqësimit me prokurë. Kërkuesi nuk e ka pranuar asnjëherë fajësinë e tij, prandaj gjykata duhet të merrte prova me dëshmitarë për të arritur në konkluzionin nëse ishte kryer ose jo vepra penale;

- Ka shkelje të rënda ligjore nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore në paraqitjen për njohje që është bërë në fazën e hetimit të çështjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesen e kërkuesit dhe shqyrtoi

çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.368, datë 14.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesi është deklaruar fajtor për veprat penale të vjedhjes, të armëmbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të armëve të ftohta, dhe në bazë të neneve 134/2, 278/2 e 279 të Kodit Penal është dënuar me 9 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, kjo gjykatë e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me 6 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.493, datë 30.06.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, lidhur me fajësinë dhe kualifikimin ligjor të veprës dhe ndryshimin e tij përsa i përket masës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.42, datë 21.01.2005 marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, përmes të cilit kërkohet prishja e vendimit të dhënë nga gjykata e apelit dhe lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën e paraqitur Gjykatës Kushtetuese, pretendohet se të tre vendimet e mësipërme janë rezultat i proceseve të parregullta ligjore, prandaj si të tilla duhet të shfuqizohen si antikushtetuese. Sipas kërkuesit, parregullsia e këtyre proceseve qëndron në moszbatimin nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të detyrimit kushtetues për t'i dhënë fuqi prapavepruese ligjit penal favorizues; në kapërcimin e tagreve të avokatit mbrojtjes, i cili në gjykimet e zhvilluara në shkallë të parë ka kërkuar gjykim të shkurtuar; tek shkeljet e rënda ligjore në paraqitjen për njohje, bërë që gjatë fazës së hetimit.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit duhet të vlerësohen në kuadër të standardeve apo elementeve, pjesë përbërëse të procesit të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Problemet e zbatimit dhe interpretimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Veç kësaj, theksohet se në konceptin e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, përfshihet edhe detyrimi për t'i dhënë fuqi prapavepruese ligjit penal favorizues.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në paragrafin e tretë të nenit 29 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë deklarohet që "Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese". Ky parim i rëndësishëm kushtetues, i cili në të drejtën romake njihet me formulën "*lex retro agit in mitius*" (ose "*les mitior retro agit*"), përmendet shprehimisht edhe në nenin 15/1 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së mbi të Drejtat Politike e Civile, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datë 4.01.1992.¹

Në fakt, ashtu si edhe në fushat e tjera të së drejtës, edhe në të drejtën penale parimi i përgjithshëm është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është mëse e nevojshme që çdo qytetar të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij, si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese.

Përfundimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen. Është e drejtë sovranë e ligjvënësit që në një moment të caktuar, në përputhje me kushtet ekonomike dhe shoqërore të vendit, politikën penale apo detyrimet ndërkombëtare, të vlerësojë si të nevojshme ndryshimin e ligjit penal, duke mos dënuar ose dënuar me masa më të buta veprime apo mosveprime të caktuara që kryen brenda territorit të tij. Dhe nëse një vlerësim i tillë është bërë tashmë nga ligjvënësi, është detyrë e organeve shtetërore (gjykatave) për ta zbatuar ligjin e ri në jetën e

1. "Përmbledhje aktesh ndërkombëtare", botuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 1994, f.21

përditshme, menjëherë dhe sa më mirë, duke pasur parasysh parimin se “... ligji më i butë duhet të zbatohet nga gjykatat kombëtare si përsa i përket përcaktimit të veprës penale, ashtu edhe sanksioneve të parashikuara prej saj...”.¹

Gjykata Kushtetuese thekson se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar menjëherë nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Pasi çështja është gjykuar përfundimisht nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk ka më vend për aplikimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Në këto kushte, ai nuk mund të përbëjë as shkak për rishikimin e çështjes nga këto gjykata.²

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i parë i kërkuesit është i drejtë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit dhe për çështjen në gjykim, duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruse, të ligjit penal favorizues. Ndër të tjera, neni 441 i Kodit të Procedurës Penale i njej të drejtën Gjykatës së Lartë të ndryshojë edhe cilësimin ligjor të veprës ose llojin dhe masën e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë apo gjykata e apelit.

Në fakt, siç rezulton edhe nga dosja gjyqësore, ky pretendim nuk është ngritur shprehimisht në rekursin që kërkuesi i ka drejtuar Gjykatës së Lartë. Në kohën e paraqitjes së rekursit nuk ishte aprovuar ende ligji nr.9275 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, ...”, i cili, ndër të tjera, ndyshoi edhe nenin 134 të këtij Kodi, duke parashikuar masa më të buta dënimi për veprën penale të vjedhjes. Ky ligj është aprovuar nga Kuvendi në datën 16.09.2004 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 7.10.2004. Megjithatë, Kolegji Penal i kësaj gjykate, në datën 21.01.2005 kur e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, kryesisht dhe vetëm për këtë shkak, duke pasur parasysh se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nuk duhet të kishte mënjanuar respektimin e këtij parimi kushtetues.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimi i kërkuesit për tejkalimin e tagreve të përfaqësimit me prokurë nga ana e avokatit të caktuar prej tij në gjykimin e bërë në gjykatën e shkallës së parë, nuk qëndron. Është e vërtetë se në seancën e datës 6.04.2004 avokati mbrojtës ka kërkuar gjykim të shkurtuar, e cila është miratuar nga gjykata, por një kërkesë e tillë është bërë në emër dhe në interes të vetë kërkuesit. Për këtë qëllim, trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është paraqitur edhe një aktperfaqësimi hartuar nga kërkuesi në datë 05.04.2004 dhe nënshkruar edhe nga përgjegjësi i dhomës së izolimit dhe drejtori i burgut 313, në të cilën kërkohet “gjykim i shkurtuar ... konform neneve 403 e vijues të Kodit të Procedurës Penale ...”, si mospjesëmarrja e vetë kërkuesit në gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër, duhet theksuar se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk ka lidhje me pranimin apo mospranimin e fajësisë, ashtu siç pretendohet në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ajo bëhet pa filluar shqyrtimi gjyqësor, dhe pranimi i saj vlerësohet nga gjykata, nëse çmohet se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

Pretendimi i kërkuesit për shkelje të rënda ligjore nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore në paraqitjen për njohje që është bërë në fazën e hetimit të çështjes, nuk mund të merret parasysh. Në rastin konkret, një pretendim i tillë nuk është ngritur në asnjë prej shkallëve të gjyimit përfshirë këtu edhe rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

1. Shih vendimin e GjEDrNj në çështjen G. kundër Francës, datë 27.09.1995

2. Shih edhe Charrier “Code de la Convention Europeene des Droits de L’homme”, Paris 2000, f.140, si dhe praktikën dhe legjislacionin francez në “Legalite des delits et des peines” – un article de Wikiberal, Encyclopedie gratuite consacre au liberalisme-2005, f.5

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.42, datë 21.01.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM Nr.36, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalice, në datë 10.06.2005 dhe 15.07.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32 Akti që i përket:

KËRKUES: ALFRED, ERNEST KAZANXHI; KRISAVGJI REKA, përfaqësuar nga avokatët Vangjel Muzina e Ilia Kona, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA DURRËS, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Flutura Guri, me autorizim.
2. MUHARREM, MYZEJEN, SHPRESA, ERMIRA ÇELKUPA E MERITA ALIKAJ, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr.1567, datë 27.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Durrës; nr.241, datë 29.04.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.313, datë 05.02.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të këtyre vendimeve:

- Gjykatat kanë cenuar parimet e paanësisë dhe të gjykatës kompetente si elemente të procesit të rregullt ligjor;
- Është bashkuar një gjykim themeli me një gjykim të bërë në bazë ankimi (rekursi), duke i vënë palët në pozita të pafavorshme;
- Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kanë parashtruar vetëm shkaqe për të cilat neni 472 i Kodit të Procedurës Civile parashikon kompetencën e atij organi për shqyrtim;
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), për mospranimin e rekursit, është marrë pa praninë e tyre, në një kohë, që e drejta për të qenë të pranishëm në gjykimin e çështjes përbën “themelin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor”.

Subjektet e interesuara kanë parashtruar:

Bashkia Durrës (Avokatura e Shtetit)

- Gjykata e Apelit Durrës i ka mohuar të drejtën e mbrojtjes, sepse nuk i ka njoftuar për ditën dhe orën e gjykimit;

- Të dyja palëve u mungon legjitimitimi aktiv në ngritjen e padisë, pasi ato nuk kanë pronë dhe nuk kanë interes të ligjshëm, siç parashikon neni 32 i Kodit të Procedurës Civile.

Trashëgimtarët Çelkupa

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ka vepruar konform kërkesave të nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile;

- Pretendimet e kërkuësve kanë të bëjnë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe jo me respektimin e parimeve themelore të procesit nga gjykatat e sistemit gjyqësor. Si rrjedhojë, shqyrtimi i këtyre pretendimeve nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese;

- Nuk mund të pranohet shkelja e parimit të gjykatës kompetente me interpretime për mënyrën e hedhjes së shortit dhe të caktimit të gjyqtarit që do të gjykojë çështjen.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuësve që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesen e Avokaturës së Shtetit që kërkoi shfuqizimin e vendimeve të gjykatës së apelit e të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përfaqësuesin e familjes Çelkupa që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.1567, datë 27.11.2001, ka vendosur pranimin e kërkesës së subjekteve të interesuara, trashëgimtarëve Çelkupa, rishikimin e vendimit nr.3627, datë 28.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe rrëzimin e padisë së kërkuësve, trashëgimtarëve Kazanxhi, për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me të cilin u ishte kthyer subjekteve të interesuara sipërfaqja 1200 m². Po me këtë vendim, gjykata e rrethit ka pranuar gjithashtu padinë e subjekteve të interesuara dhe ka anuluar pjesërisht vendimin nr.100, datë 15.10.1993 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me të cilin u kthehej kërkuësve, sipërfaqja prej 1200 m².

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.241, datë 29.04.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), me vendimin nr.313, datë 5.02.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësit dhe Avokatura e Shtetit.

Kërkuësit kanë ngritur disa pretendime për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore, por në çështjen në shqyrtim Gjykata Kushtetuese do të përqendrohet tek ato probleme që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor. Në këtë këndvështrim, ka rëndësi të veçantë të analizohet pretendimi për cenimin e parimit të paanësisë si një nga garancitë e "gjykimit të drejtë" që mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike.

Paanësia vlerësohet si raport midis përpjekjes për të përcaktuar atë që gjyqtari mendon në ndërgjegjen e tij të brendshme në rrethanat e ndërhyrjeve e presionit, dhe përpjekjes objektive për të ballafaquar veprimet e gjyqtarit me funksionin e tij dhe madje me dukjen e tij, me qëllim që të ofrojë garancitë e mjaftueshme duke përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm.

Në çështjen në gjykim, konstatohet se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës nuk u kanë ofruar palëve garancitë e nevojshme që do t'u largonte atyre shqetësimin për njëanshmërinë e gjykatës. Përkundrazi, disa nga gjyqtarët e asaj gjykate, jo vetëm kanë kërkuar të largohen nga gjykimi, por kanë kryer edhe veprime që kanë vënë në dyshim paanësinë e tyre. Kështu, në seancën e datës 12.03.2002, gjyqtarët e çështjes nuk janë paraqitur në gjykim, dhe megjithëse sekretarja e seancës u deklaroi palëve se gjyqtarët e asaj gjykate janë tërhequr nga gjykimi e se çështja do të gjykohet nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë, në seancën e datës 18.03.2002, u riparaqit në përbërjen e trupit gjykues ish-relatori i çështjes. Jo vetëm kaq, por në seancat në vazhdim u bënë publike edhe dorëheqjet e dy gjyqtarëve të ardhur nga Gjykata e Apelit Korçë, të cilat, ndonëse nuk u pranuan nga kryetari i gjykatës, përforcuan më tej shqetësimin e kërkuësve për mungesën e paanësisë së gjykatës, për shkak të ndërhyrjeve e presioneve.

Gjykata e apelit, në seancën e datës 18.03.2002, nuk vlerësoi shqetësimin e përligjur të kërkuësve dhe refuzoi kërkesën e avokatit të tyre për përjashtimin e ish-relatorit të çështjes. Justifikimi i rrëzimit të kësaj kërkeje me shkaqet e nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile nuk harmonizohet me detyrimin që kanë gjykatat për respektimin e parimeve kushtetuese të procesit të rregullt e të

paanësisë. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate të paanëshme kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por ajo duhet të shikohet që bëhet. Gjykata e Apelit Durrës, nuk u shpjegoi palëve arsyet e riparaqitjes në trupin gjykues të ish-relatorit të çështjes. Ajo gjithashtu nuk pranoi të verifikonte pretendimet e kërkuësve për pozicionimin paraprak të gjyqtarëve në favor të palës tjetër. Ndryshimi i relatorit nuk ishte i mjaftueshëm për t'i bindur palët për objektivitetin e gjyqtarëve përderisa ai merrte pjesë përsëri si anëtar i trupit gjykues me të drejtë vote. Këto janë disa nga arsyet që avokatët e kërkuësve kundërshtuan menjëherë pjesëmarrjen e tij dhe kur kjo kërkesë nuk u pranua, ata të bindur për anësinë e gjykatës, kundërshtuan gjithë përbërjen e trupit gjykues. Të gjitha seancat e tjera u karakterizuan nga një frymë mosbesimi në paanësinë e gjykatës, nxitur nga vetë qëndrimet e gjyqtarëve.

Duke u nisur nga sa mësipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se është cenuar parimi i paanësisë që garanton rendin e së drejtës dhe që mundëson krijimin e besimit ndaj gjykatës. Janë vetë qëndrimet e gjykatës që krijuan te kërkuësit, të paditur në gjykim, dyshimin e përligjur se gjyqtarët nuk i rezistonin dot ndërhyrjeve e presioneve dhe si rrjedhojë, nuk përmbushnin garancitë kushtetuese për të qenë të paanshëm në gjykim.

Kërkuësit, pretenduan gjithashtu se në çështjen në gjykim është cenuar parimi i gjykatës kompetente duke e arsyetuar këtë me mosrespektimin e rregullave për hedhjen e shortit.

Zbatimi i rregullave për hedhjen e shortit është garanci për një proces të rregullt gjyqësor, por në gjykim kërkuësit nuk mundën të provojnë që trupi gjykues u formua pa u zbatuar rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Cenimi i këtij parimi nuk mund të konsiderohet si i vërtetuar vetëm nga deklaratimet e kërkuësve se përbërja e trupit gjykues dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes janë vendosur me makinacione qysh para gjykimit.

Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi gjithashtu as cenim të parimit të barazisë së palëve nëpërmjet bashkimit të çështjeve që i venë ato në pozita të pafavorshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e formës së prerë nr.45, datë 21.09.1999, kishte vendosur pranimin e kërkesës së subjekteve të interesuara (familjes Çelkupa) për rishikimin e çështjes. Me këtë vendim, gjykata diskutoi për probleme që u takonin provave të reja dhe kuadrit ligjor të rishikimit, ndërsa gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, pas pranimi për rishikim, gjykatat shqyrtuan çështjen në tërësi së bashku me padinë e subjekteve të interesuara, për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhënë në favor të kërkuësve. Parimi i barazisë nënkupton që secila palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur pretendimet e provat, që të mos ketë përparësi të një pale ndaj tjetrës dhe që secila të ketë informacionin e duhur për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare. Në rastin në shqyrtim, nuk provohet që të ketë pasur shkelje të tilla që të përbëjnë cenim të parimit kushtetues të barazisë së palëve në proces.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se duke u cenuar parimi i paanësisë si një element i procesit të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës duhet shfuqizuar dhe çështja duhet dërguar për rigjykim po në atë gjykatë. Së bashku me të duhet shfuqizuar edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka korrigjuar shkeljet e asaj gjykate.

Përsa i përket pretendimeve të avokates së shtetit se gjykata e apelit i ka mohuar të drejtën e mbrojtjes nga që nuk i ka njoftuar për gjykim, dhe se të dyja palëve u mungon legjitimitimi aktiv nga që nuk kanë pronë, këto nuk mund të jenë shkaqe për shfuqizimin e vendimit në Gjykatën Kushtetuese, sepse Avokatura e Shtetit nuk e ka vënë atë në lëvizje.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.241, datë 29.04.2002 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.313, datë 05.02.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 37, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 13.09.2005, 27.09.2005 dhe 25.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket:

KËRKUESI: AGIM CANI, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Gentiana Dorëzi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.534, datë 13.07.2005 i Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Kamëz, qarku Tiranë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e këtij vendimi:

- Në veprimet e mia nuk gjendet asnjë element apo veprim i kundërligjshëm dhe përgjegjësi pa faj nuk ka;

- Nëse janë evidentuar shkelje, përgjegjësi duhet të mbajë zyra e gjendjes civile, e cila vetëm administrativisht varet nga kryetari i komunës, por në kuptimin e ushtrimit të funksioneve të saj varet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

- Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk disponojnë ndonjë urdher të lëshuar prej kësaj të fundit apo ndonjë provë që të vërtetojë shkelje të ligjit nga kryetari i bashkisë.

Subjekti i interesuar: Nuk kemi asnjë provë që të vërtetojë shkelje të rënda nga kërkuesi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar që u shprehën për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Sipas propozimit të ish-Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.534, datë 13.07.2005, ka shkarkuar nga detyra e kryetarit të Bashkisë Kamëz, qarku Tiranë, kërkuesin Agim Cani, “për shkelje të rënda ligjore”, duke u bazuar në nenet 100 e 115 të Kushtetutës.

Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave është akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë e kësaj gjykate buron nga një dispozitë konkrete kushtetuese (neni 115/2 i Kushtetutës) dhe përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ.

Sipas relacionit të ministrit të lartpërmendur, shkeljet e rënda ligjore konsistojnë në faktin që

zyra e gjendjes civile e Bashkisë Kamëz, ka lëshuar gjatë periudhës parazgjedhore, si dhe ditën e zgjedhjeve dokumente që janë përdorur si mjet identifikimi për të votuar, të cilat nuk kanë qenë sipas standardeve e formës së përcaktuar. Po sipas relacionit, shkeljet e rënda të ligjit, konsistojnë gjithashtu edhe në shtimin e numrit të zgjedhësve në listat e zgjedhësve duke i regjistruar këta dy ose më shumë herë.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese rezultoi se zyra e gjendjes civile të Bashkisë Kamëz, ka lëshuar në periudhën 28.06.2005-3.07.2005 certifikata lindje me kompjuter, të cilat janë përdorur nga zgjedhësit si mjet identifikimi për të votuar. Këto certifikata, ndonëse mund të përputheshin me regjistrat themeltarë të shtetasve, nuk ishin sipas standardeve dhe formës së përcaktuar në vendimin nr.828, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për formën, mënyrën e mbajtjes, elementet përbërëse dhe afatin e përdorimit të dokumenteve nga zyrat e gjendjes civile”, si dhe urdhrit nr.5, datë 29.01.2004 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për specifikimet teknike të shtypshkrimeve të dokumenteve të gjendjes civile”.

Në gjykimin e çështjes nuk u vërtetua që shkeljet e mësipërme të jenë kryer nga kërkuesi dhe as me dijeninë e tij, prandaj nuk mund të pranohet se në rastin në shqyrtim ai ka kryer shkelje të tilla që të konsiderohen të rënda në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës. Ato, gjithashtu, nuk kanë sjellë pasoja të rënda në veprimtarinë e organeve shtetërore. Nga dokumentet e paraqitura si prova vërtetohet se kërkuesi ka lëshuar urdhra me detyra konkrete për zbatimin e ligjit për mbarëvajtjen e punës në zyrën e gjendjes civile. Me të konstatuar lëshimin e certifikatave, në kundërshtim me rregullat, ai ka ndërhyrë personalisht, ka urdhëruar ndërprerjen e dhënies së tyre, duke e shoqëruar me marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës.

Lidhur me pretendimin tjetër, për regjistrimin dy herë të zgjedhësve në listat e zgjedhësve, përfaqësuesja e Këshillit të Ministrave nuk paraqiti asnjë provë në këtë drejtim. Vlen të theksohet gjithashtu se pretendimet e mësipërme janë ngritur nga subjekti elektoral Partia Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe ky i fundit, me vendimin nr.1586, datë 22.07.2005, ka rrëzuar kërkesën për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në atë zonë duke arsyetuar së pari, që lëshimi i certifikatave nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve dhe së dyti, që nuk u vërtetua pretendimi për shtimin e numrit të zgjedhësve në lista. Jo vetëm kaq, por nga shkresa nr.7482, datë 18.10.2005 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezulton që kërkuesi të jetë marrë në përgjegjësi penale, megjithëse ajo ka kryer veprime hetimore për parregullsitë në procesin zgjedhor, në atë zonë.

Përsa më sipër, vendimi i kundërshtuar i Këshillit të Ministrave duhet të deklarohet si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.534, datë 13.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Kamëz të qarkut të Tiranës”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.38, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 16.09.2005, 29.09.2005 dhe 10.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42 Akti, që i përket:

KËRKUES: BESIM FEJZA, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Gentiana Dorëzi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.527, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të komunës Sllovë, qarku Dibër”.

BAZA LIGJORE: Neni 115 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave cenon rëndë pavarësinë e pushtetit vendor;
- Nuk është konstatuar asnjë shkelje e rëndë e Kushtetutës apo e ligjeve që të legjitimonte shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës;
- Ka përmbushur detyrat sipas ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Subjekti i interesuar: Vendimi i shkarkimit nuk bazohet në prova e në ligj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar që u shprehën për pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me propozimin e ish-Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.527, datë 8.07.2005, ka vendosur shkarkimin nga detyra e Kryetarit të Komunës Sllovë, qarku Dibër, kërkuesin Besim Fejza, me motivacionin për shkelje të rënda ligjore.

Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave është akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë e kësaj gjykate buron nga një dispozitë konkrete kushtetuese (neni 115/2 i Kushtetutës) dhe përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ.

Sipas relacionit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, duke filluar nga muaji qershor 2004, kjo ministri ka shpërndarë në të gjitha zyrat e shërbimit të gjendjes civile, certifikata me elemente sigurie. Por, që nga muaji dhjetor 2004, janë evidentuar vjedhje të disa serive të këtyre dokumenteve në disa njësi të qeverisjes vendore. Në komunën Sllovë, qarku Dibër, ky fenomen ka ndodhur në datën 23.04.2005. Në mesnatë, persona të panjohur kanë hapur me forcë derën e jashtme të zyrave të komunës, e cila kishte qenë me çelës, dhe më pas me mjete të forta kanë thyer derën e zyrës së gjendjes civile ku kanë marrë të gjithë sasinë e certifikatave të papërdorura që kanë qenë gjendje në atë zyrë.

Në relacionin e ministrit është shprehur opinioni se kjo “vjedhje nuk është e rastësishme, por është bërë për qëllime abuzive për të krijuar mundësinë e përdorimit të tyre si mjet identifikimi për zgjedhjet”. Po sipas relacionit, përgjegjësia e kryetarit të komunës qëndron në atë se duke mos marrë masat e domosdoshme për sigurimin e këtyre dokumenteve, ka krijuar mundësinë e përdorimit të tyre

në mënyrë të paligjshme.

Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi shkelje të rënda ligjore në veprimtarinë e kërkuesit në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Në zbatim të detyrave të tij, të parashikuara në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe duke u bazuar në vendimin nr.4, datë 24.03.2005 të këshillit të komunës Sllovë “Për strukturën organizative të komunës”, kërkuesi ka caktuar rojen e objektit duke lidhur edhe kontratën e punës me të, ku përcaktohen detyrat përkatëse. Po kështu, komuna ka pasur të punësuar nëpunësin e gjendjes civile, i cili përgjigjej jo vetëm për rregullshmërinë e dokumentacionit të asaj zyre, por edhe për ruajtjen e tyre sipas rregullave.

Nëse në ditën e ngjarjes është konstatuar mungesa në detyrë e rojes së objektit, si dhe dokumente jashtë kasafortës, kjo ngarkon me përgjegjësi direkte rojen dhe nëpunësin e gjendjes civile. Për kryetarin e komunës, nuk konstatohen shkelje të ligjit dhe aq më tepër shkelje të rënda të ligjit, në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës që përligjin shkarkimin e tij nga detyra. Jo vetëm kaq, por nga kjo vjedhje nuk vërtetohet ndonjë pasojë në zhvillimin e zgjedhjeve në atë zonë, sepse certifikatat u nxorrën menjëherë jashtë përdorimit dhe nuk pati raste të votimit dy ose më shumë herë nga i njëjti person.

Edhe prokuroria, e cila ka filluar çështjen penale mbi bazën e kësaj ngjarjeje, sipas nenit 134 të Kodit Penal, ka pezulluar procedimin për moszbulim autori.

Përsa më sipër, vendimi i kundërshtuar i Këshillit të Ministrave duhet të deklarohet si i papajtueshëm me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.527, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Sllovë të qarkut Dibër”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.39, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 14.09.2005, 27.09.2005 dhe 25.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 Akti, që i përket:

KËRKUESI: ARANIT SKEPI, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Gentiana Dorëzi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.529, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Fushë Çidhën, qarku Dibër”.

BAZA LIGJORE: Neni 115 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

Kërkuesi ka parashtuar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave cenon rëndë pavarësinë e pushtetit vendor;

- Detyrat e kryetarit të komunës janë përmbushur në pajtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

- Nuk janë vërtetuar shkelje që në kuptim të nenit 42 të ligjit të mësipërm të përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra si kryetar komune;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkim mbështetet vetëm në dyshime të pabazuara, duke aluduar edhe për detyrime që de jure nuk i takojnë kryetarit të komunës.

Subjekti i interesuar: Vendimi i shkarkimit nuk bazohet në prova e në ligj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.529, datë 08.07.2005, në bazë të neneve 100 e 115 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ka shkarkuar nga detyra e kryetarit të komunës Fushë Çidhën të Qarkut Dibër, kërkuesin Aranit Skepi, me motivacionin për shkelje të rënda ligjore.

Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave është akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë e kësaj gjykate buron nga një dispozitë konkrete kushtetuese (neni 115/2 i Kushtetutës) dhe përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ.

Sipas relacionit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, duke filluar nga muaji qershor 2004, kjo ministri ka shpërndarë në të gjitha zyrat e shërbimit të gjendjes civile, certifikatat për përdorim brenda vendit, si dhe ato për jashtë shtetit, dokumente këto me elementë të larta sigurie. Nga muaji maj 2004, është evidentuar zhdukja e disa serive të këtyre certifikatave në disa njësi të qeverisjes vendore. Në komunën Fushë-Çidhën, qarku Dibër, ky fenomen ka ndodhur në datën 3.07.2005.

Në relacion, është shprehur opinioni se kjo “vjedhje” nuk është e rastësishme, por është bërë për qëllime abuzive për të krijuar mundësinë e përdorimit të tyre si mjet identifikimi për zgjedhësit”. Në përfundim të relacionit shprehet konstatimi se kryetari i komunës nuk ka marrë masat e domosdoshme për sigurimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme shtetërore, duke krijuar mundësinë e përdorimit të tyre në mënyrë të paligjshme.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të komunës është i pabazuar. Në kryerjen e detyrës së tij nuk konstatohen shkelje të rënda të ligjit, në kuptim të nenit 115 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kështu, nga shqyrtimi i kësaj çështje, ka rezultuar se në datën 8.01.2005 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, mbi bazën e materialeve kallzuese të Komisarariatit të Policisë Dibër, ka filluar procedimin penal nr.12, pa autor, për vjedhjen e zyrës së gjendjes civile të komunës Fushë Çidhën, nga ku ka rezultuar vjedhja e një sasie certifikatash. Ky procedim, për mungesë autori, është pezulluar në datën 8.06.2005. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, në datën 10.07.2005, ka filluar procedimin penal nr.89, pa autor. Siç rezulton edhe nga relacioni i mësipërm i Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe

Decentralizimit, pikërisht, këto dy ngjarje kanë shërbyer si shkak për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës, të kërkuesit Aranit Skepi.

Në kundërshtim me sa pretendohet në këtë relacion, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në veprimtarinë e kërkuesit nuk konstatohen shkelje të ligjit, që të kenë ndikuar në cenimin e masave për ruajtjen e dokumenteve të gjendjes civile. Konkretisht, për ruajtjen e dokumenteve, zyra e gjendjes civile ishte e pajisur me kasafortë, ishte e siguar me zgarë hekuri dhe për ruajtjen e objektit të komunës, ku përfshihet edhe zyra e gjendjes civile, ishte caktuar rojë. Nga ana tjetër, humbja e certifikatave ka qenë rezultat i vjedhjes me thyerje. Përveç kësaj, nuk vërtetohet se këto dokumente janë përdorur në zgjedhjet e 3 korrikut 2005. Gjykata Kushtetuese vlerëson se përderisa nuk vërtetohet se kërkuesi ka lejuar shkeljen e rregullave të ruajtjes së dokumenteve, vetëm fakti i vjedhjes së këtyre dokumenteve nuk e ngarkon atë me përgjegjësi.

Përsa më sipër, vendimi i kundërshtuar i Këshillit të Ministrave duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.529, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Fushë-Çidhën të qarkut Dibër”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 40, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 15.09.2005, 28.09.2005 dhe 10.10.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.43 Akti, që i përket:

KËRKUES:HAXHI DAMZI, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: KESHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Gentiana Dorëzi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.528, datë 8.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Luzni, qarku Dibër”.

BAZA LIGJORE: Neni 115 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave cenon rëndë pavarësinë e pushtetit vendor;
- Janë përmbushur detyrat e kryetarit të komunës, siç parashikon ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;
- Nuk janë vërtetuar shkelje që në kuptim të nenit 42 të ligjit të mësipërm të përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra si kryetar komune;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkim mbështetet vetëm në aludime dhe detyrime që *de jure* nuk i takojnë kryetarit të komunës.

Subjekti i interesuar: Nuk disponojmë asnjë provë që të vërtetojë shkelje ligji nga kërkuesi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me propozim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.528, datë 8.07.2005, në bazë të neneve 100 e 115 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ka shkarkuar nga detyra e kryetarit të komunës Luzni të qarkut Dibër, kërkuesin Haxhi Damzi, me motivacionin për shkelje të rënda ligjore.

Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave është akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë e kësaj gjykate buron nga një dispozitë konkrete kushtetuese (neni 115/2 i Kushtetutës) dhe përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ.

Sipas relacionit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, duke filluar nga muaji qershor 2004, kjo ministri ka shpërndarë në të gjitha zyrat e shërbimit të gjendjes civile, certifikata me elemente të larta sigurie. Nga muaji dhjetor 2004, është evidentuar zhdukja e disa serive të këtyre certifikatave në disa njësi të qeverisjes vendore. Në komunën Luzni të qarkut Dibër, ky fenomen ka ndodhur në datën 22.05.2005. Në relacion është shprehur opinioni se kjo “vjedhje” nuk është e rastësishme, por është bërë për qëllime abuzive, për të krijuar mundësinë e përdorimit të tyre si mjet identifikimi për zgjedhësit. Në përfundim, në relacion shprehet konstatimi se kryetari i komunës nuk ka marrë masat e domosdoshme për sigurimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme shtetërore, duke krijuar mundësinë e përdorimit të tyre në mënyrë të paligjshme.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të komunës është i pabazuar. Në kryerjen e detyrës së tij nuk konstatohen shkelje të rënda të ligjit.

Kështu, nga shqyrtimi i kësaj çështje, ka rezultuar se në datën 23.05.2005, në orën 06.⁰⁰ është konstatuar vjedhja me thyerje e zyrës së gjendjes civile të komunës Luzni të qarkut Dibër. Mbi bazën e njoftimit të kryetarit të komunës, kërkuesit Haxhi Damzi, grupi hetimor ka konstatuar vjedhjen e 1200 certifikatave dhe të vulës së kësaj zyre. Mbi bazën e materialit kallzues të Komisarariatit të Policisë Dibër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, në datën 30.05.2005, ka filluar procedimin penal nr.69, pa autor, për veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Pas veprimeve të kryera, në datën 15.06.2005, është vendosur pezullimi i procedimit.

Në këto rrethana, në kundërshtim me sa pretendohet në relacionin e mësipërm, Gjykata Kushtetuese në veprimtarinë e kërkuesit si kryetar i komunës, nuk konstaton shkelje të ligjit, që të kenë ndikuar në cenimin e masave për ruajtjen e dokumenteve të gjendjes civile. Kështu, gjatë gjykimit rezultoi se certifikatat kanë qenë në ruajtje në kasafortë hekuri, ndërsa zyra ishte e siguruar edhe me zgarë hekuri. Është e vërtetë se objektet e komunës, ku përfshihet edhe zyra e gjendjes civile, nuk ruheshin me rojë, por në këtë drejtim, kërkuesi, me cilësinë e kryetarit të komunës, ka bërë të gjitha përpjekjet për caktimin e një rojë objekti. Kështu, nga ana e tij, në bazë të ligjit të mësipërm “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, këshilli të komunës si organ kompetent për miratimin e strukturës organike të komunës, i është paraqitur projektvendimi për këtë qëllim, por nga ana e këtij këshilli, për mungesë fondesh, nuk është miratuar caktimi i rojës në organikën e komunës. Për pasojë, kërkuesi nuk ka përgjegjësi për moscaktimin e rojës së objektit. Në tërësinë e rrethanave, Gjykata Kushtetuese ka parasysh edhe faktin se që në momentin e konstatimit të vjedhjes së

certifikatave është bërë nxjerrja e tyre jashtë përdorimit, duke njoftuar subjektet përkatëse, si dhe faktin se gjatë gjykimit nuk u provua se këto certifikata janë përdorur për qëllime abuzive në zgjedhjet e 3 korrikut 2005.

Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se përderisa nuk vërtetohet se kërkuesi ka lejuar shkeljen e rregullave të ruajtjes së dokumenteve në shqyrtim, vetëm fakti i vjedhjes së certifikatave, nuk e ngarkon atë me përgjegjësi.

Përsa më sipër, vendimi i kundërshtuar i Këshillit të Ministrave duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115 të Kushtetutës si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.528, datë 08.07.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Luzni të qarkut Dibër”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 41, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtar e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 29.04.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen Nr.23 Akti, që i përket:

KËRKUES:

1. ARBEN BËRBALLA, përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku, me prokurë.

2. SOKOL KOÇIU, përfaqësuar nga avokat Arben Qeleshi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga Skënder Breca, me autorizim

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.356, datë 14.04.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.327, datë 28.05.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesit Arben Bërballa e Sokol Koçi kanë pretenduar se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor, gjë që sipas tyre, në mënyrë të përmbledhur, shfaqet në

drejtimet e mëposhtme:

1. Janë shkelur ndalimet e parashikuara në nenin 29 të Kushtetutës dhe konkretisht:
 - vepra penale e trafikut të narkotikëve, në kohën kur gjykatat deklarojnë krijimin e organizatës, nuk parashikohej në Kodin Penal;
 - kërkuesit janë akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/a/2 të Kodit Penal, por pa e ndryshuar akuzën, janë deklaruar fajtorë e dënuar në bazë të nenit 284/a/1 të këtij Kodi duke u rënduar padrejtësisht pozitën;
 - kërkuesi Sokol Koçiu është dënuar për veprën penale të falsifikimit me 9 vjet burgim, pra me një dënim që është më i lartë se maksimumi që parashikon neni 189 i Kodit Penal;
 - gjykata e shkallës së parë ka zbatuar ligjin penal me analogji.
2. Është shkelur rregulli i parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës për mosdënimin më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale.
3. Është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe konkretisht:
 - në gjykatën e shkallës së parë njëri nga anëtarët nuk mund të merrte pjesë në përbërjen e trupit gjykues;
 - trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë është formuar në kundërshtim me nenin 28/4 të ligjit nr.8456, datë 23.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
4. Është shkelur rregulli i parashikuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe konkretisht:
 - e quajtura L.Cestari është pyetur si dëshmitare në shkelje të nenit 31/d të Kushtetutës, si dhe të nenit 6/3/d të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
 - dëshmia e të quajturit T.Mateus është pranuar si provë në kundërshtim me rregullat procedurale;
 - aktet e dosjes nr.1010/99 të ardhura nga Italia, në bazë të neneve 193, 505 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 3, 14, 15 të Konventës së Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” të datës 20 prill 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997, nuk mund të konsiderohen si prova të vlefshme.
5. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e ka zhvilluar seancën gjyqësore të datës 18.03.2003 pa praninë e mbrojtësit.
6. Dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk mund të shqyrtojë çështjen në themel, pasi një të drejtë të tillë e ka Kolegji Penal në seancë gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes Petrit Plloçi e Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.356, datë 14.04.2003, ka deklaruar fajtor kërkuesin Arben Bërballa për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale me qëllim trafikimin e paligjshëm të narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/2 të Kodit Penal si dhe të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal ka caktuar një dënim përfundimtar prej 15 vjet burgim. Po me këtë vendim, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, ka deklaruar fajtor kërkuesin Sokol Koçiu për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale me qëllim trafikimin e narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/2 i Kodit Penal, të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, si dhe falsifikimit të letër njoftimeve apo vizave, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal i ka caktuar një dënim përfundimtar prej 15 vjet burgim.

Mbi apelin e kërkuesve Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.599, datë 15.11.2003, lidhur me kërkuesit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.327, datë 28.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura edhe nga kërkuesit Arben Bërballa dhe Sokol Koçiu.

Në kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuesit kanë pretenduar se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor. Parregullsia e procesit sipas kërkuesve, qëndron në shkeljen e parimit të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës, i cili parashikon mosdënimin pa ligj (nullum crimen nulla poena sine lege), të nenit 32/2 që parashikon parimin e mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme të nenit 34 që parashikon mosdënimin më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykimit sërish (ne bis in idem), si dhe të parimeve të tjera, të sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstaton se përveç së drejtës për një proces të rregullt ligjor (nenit 42), disa nga të drejtat e tjera kushtetuese individuale që parashikohen në nenet 29, 31, 32, 34 etj. të Kushtetutës shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj se pretendimet për shkeljen e parimeve themelore që përmbajnë këto të drejta themelore individuale, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, janë objekt shqyrtimi në këtë gjykatë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në këtë Gjykatë janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë duhet të investojë në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj.

Përsa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i atakuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.327, datë 28.05.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 9.1.2006

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë